REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKU
Nr/Br. 871/20
Datë/Datum. 24.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.871/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Goran Milenković - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Solution D" SH.P.K.-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE N.SH.T "Made-Kos" D.E-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me Sterilizator Plazma me Material përcjellës hargjues" me nr. të prokurimit 220-70001-20-5789-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - "Spitali i Përgjithshëm në Gjilan", më datën: 23.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Solution D" SH.P.K,-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me Sterilizator Plazma me Material përcjellës hargjues" me nr. të prokurimit: 220-70001-20-5789-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "Spitali i Përgjithshëm në Gjilan".

II. **ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me Sterilizator Plazma me Material përcjellës hargjues" me nr. të prokurimit: 220-70001-20-5789-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "Spitali i Përgjithshëm në Gjilan", dhe lënda të kthehet në **rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Solution D"SH.P.K.-Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "Solution D"SH.P.K.-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 30.10.2020 me nr. 871/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me Sterilizator Plazma me Material përcjellës hargjues" me nr. të prokurimit: 220-70001-20-5789-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - "Spitali i Përgjithshëm në Gjilan", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 10, 59, 60, 64, 67 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 03.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 05.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Pas shqyrtimit ne detaje te procedurës se tenderit si dhe shqyrtimit te pretendimeve ankimore te OE dhe dokumentacioni ne dispozicion te kësaj procedure te prokurimit eksperti shqyrtues jep këtë mendim: AK ne procedurën e tenderimit ka pasur gjithsejtë tri (3) oferta nga ana e operatoreve ekonomik, që të tre (3) operatoret ekonomik janë te shpallur te përgjegjshëm nga ana e komisionit vlerësues. Ne bazë te Nenit 59 te LPP është përgjegjësi e Komisionit dhe Autoriteti kontraktues qe te bej vlerësimi, krahasimin dhe ekzaminimin e ofertave tenderuese te operatoreve ekonomik.

Pretendimi ankimor i OE ,

"SOLUTION D" SH.P.K është se Autoriteti kontraktues nuk ka lejuar qasjen ne dokumentet tenderuese me arsyetimin se janë te klasifikuara si sekrete afariste ne bazë te Nenit 11 te LPP.

Operatori ekonomik ankues "SOLUTION D" SH.P.K me datën 23.10.2020 ka paraqitur kërkesën për qasje ne dokumentet tenderuese te operatoreve ekonomik ofertues. Në bazë te Nenit 114 te LPP paragrafit 1 pikës (ii) kam kontaktuar autoritetin kontraktues me datën 03.11.2020 lidhur me kërkesën për qasje ne dokumentet tenderuese te paraqitur nga ana e OE ankues ku kam kërkuar nga AK si ne vijim: „ Po ju shkruaj ne cilësinë e ekspertit shqyrtues lidhur me procedurën e prokurimit "Furnizim me Sterilizator Plazma me Material përcjellës hargjues" me nr. të prokurimit 220-70001-0731-20-5789-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK), Spitali i Përgjithshëm ne Gjilan. Ne këtë procedurë siç jeni te njoftuar keni ankesë te dorëzuar ne OSHP nga ana e OE sipas ankesës nr. 871/20 te dt. 30.10.2020. Pretendim ankimor është mos lejimi ne qasjen e dokumenteve te operatorit ekonomik ne baze te LPP, ju lutemi na dërgoni vendimin e AK mbi pranimin e sekretit afarist te paraqitur nga ana e OE si dhe procesverbalin e qasjes. Mundësisht brenda ditës te përgjigjeni ne kërkesën tone".

Me datën 04.11.2020 kam pranuar këtë përgjigje nga ana e AK si ne vijim: „ I nderuar z. Bajrami ne attachment gjeni te bashkangjitur deklaratën afariste. Ndërsa lidhur me kërkesën tuaj për procesverbalin e qasjes nuk kemi bere e kemi njoftuar edhe ne email, edhe pse operatori ekonomik ka qene zyrtarisht ne zyre tona i ka shikuar te gjitha dokumentet dhe ka thënë qe te gjitha i paska , por e kam njoftuar se nuk kam te drejti ti jap sepse është nënshkruar ANEKS 3 . Sa i përket te gjitha dokumentet tjera janë ne Sistem E Prokurim. Autoriteti kontraktues me rastin e paraqitjes se sekretit afarist nga ana e operatorit ekonomik është dashur qe te veproj konform Nenit 11 paragrafit 5 te LPP-së dhe te trajtoj ne mënyrë te duhur sekretin afarist te paraqitur nga ana e OE, dhe AK nuk ka respektuar këtë dispozitë duke mos treguar, njoftuar se cilat dokumente pranohen si sekret afarist por qe ka pranuar të gjitha si te tilla, Andaj ne këtë rast AK është dashur që ne bazë te Nenit 11 paragrafit 3 te shqyrtoj se kërkesat për sekret afarist e ter dokumentacionit ai përmbushin pikat 3.1, 3.2 dhe 3.3 te paragrafit 3 te Nenit 11 te LPP, andaj pretendimi ankimor i operatorit ekonomik është i bazuar dhe udhëzohet AK qe te veproj konform Nenit 7, 10 dhe 11 sa i përket qasjes se dokumentet tenderuese. Pretendimi ankimor se OE i rekomanduar "SOLUTION D SH.P.K", nuk ka „Vërtetim nga banka se ka qarkullim bankar se paku tri vitet e fundit ndërsa si dëshmi është kërkuar OE duhet te dëshmoj me vërtetim nga banka komerciale qe ka qarkullim 120,000.00 euro për tri vitet e fundit. Nuk qëndron dhe është i pa bazuar pasi që OE ka prezantuar dokumentin, vërtetimin bankar nga banka PCB me qarkullim konform kërkesës se Dosjes se tenderit, andaj ky pretendim është i pa bazuar.

Pretendimi ankimore se operatori ekonomik i rekomanduar "SOLUTION D SH.P.K", nuk ka dokumentet sipas dosjes se tenderit te kërkuara tek kapaciteti teknik dhe profesional neni 91.&9.2 i dosjes se tenderit, është pa bazuar pasi që Operatori ekonomik i rekomanduar ka dorëzuar: 1.)Listën e kontratave te realizuara për tri vitet e fundit (operatori ekonomik ka prezantuar listën e kontratave dhe referencat) 2.)Autorizim nga prodhuesi për shitje dhe servisim *(BIOBASE BIODUSTRY (SHANDONG) CO.LTD* te datës 13.10.2020 3.)

Certifikata ISO 13485 për prodhuesin dhe CE Certifikata për prodhuesin (Certifikata ISO 13485:2016 ME NR. 45014; CE Certifikatën nga prodhuesi me nr. BKSD-20101302; CE 1282 ECM PED – D1 2018-DD33) 4).Lista e pjesëve rezervë (nga prodhuesi me gjithsejtë 12 artikuj e cila përmban edhe vulën e prodhuesit). 5).Katalogu i nënvizuar (operatori ekonomik ka katalogun e nënvizuar nga prodhuesi BIOBASE). 6).Licenca nga AKPPM (operatori ekonomik ka prezantuar Licencën).

Kurse Certifikata ISO 9001 me anë te sqarimeve te publikuara ne e-prokurim nga ana e AK me datën 09.10.2020 është larguar si kërkesë andaj edhe ky pretendim ankimor është pa bazuar.

Pretendimi ankimor, se AK nuk është përgjigjur ndaj kërkesës për rishqyrtim te parashtruar nga ana e operatorit ekonomik , "SOLUTION D SH.P.K" nuk qëndron pasi që OE me datën 27.10.2020 ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim pran AK kurse AK me datë 29.10.2020 ka kthyer përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim e cila është brenda afateve te përcaktuara me LPP, Nenin 108/A paragrafin 6 andaj pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke pasur parasysh sqarimet e lartcekura dhe bazuar ne zhvillimin e procedurës se prokurimit dhe dokumentacionit te ofertave dhe vlerësimit, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie te kontratës dhe procedura te kthehet ne rivlerësim, rekomandohet AK që te respektohet Neni 59 i LPP si dhe Nenet 7, 10, 11 gjatë procedurës se rivlerësimit dhe pas saj.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 05.11.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 09.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik: "Solution D" SH.P.K-Prishtinë me datë: 09.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk-pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Përgjigje në ekspertizën Nr. 871/20 TË DT. 05.11.2020 Ne konfirmojmë pranimin e ekspertizës Nr. 871/20 të dt. 05.11.2020 dhe ju informojmë se NUK pajtohem me konstatimet e ekspertit shqyrtues. Ne pajtohemi me përgjigjen në pretendimin Nr .1 të ekspertit shqyrtues.

Sa i përket konstatimit nr. 2 të ekspertit shqyrtues, nuk pajtohem sepse nuk është prezantuar asnjë dëshmi në lidhje me Vërtetimin nga banka që tregon se OE i rekomanduar për kontratë ka qarkullim bankar se paku 120,000.00 € për tri vitet e fundit edhe pse eksperti shqyrtues ka konstatuar se është prezantuar dokumenti.

Andaj nëse është prezantuar dokumenti siç ka pretenduar eksperti shqyrtues, atëherë është dashur të na ofrohet dëshmia për vërtetimin. Andaj ne jemi të habitur se si mundet që eksperti shqyrtues të konstatojë se është prezantuar dokumenti përderisa nuk janë ofruar dëshmitë që ekziston ky dokument. Edhe sa i përket përgjigjes në pretendimin Nr. 3 të ekspertit, ne nuk pajtohemi sepse nuk është ofruar asnjë dëshmi sipas kërkesës se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar Listën e kontratave për tri vitet e fundit, autorizimin nga prodhuesi për shitje dhe servisim, Listën e pjesëve rezervë, katalogun e nënvizuar Licencën nga AKPPM. Pra nuk janë ofruar dëshmia adekuate në Lidhje me këto kërkesa. Ndërsa në Lidhje me konstatimin e ekspertit se OE i rekomanduar për kontratë i ka prezantuar Certifikatën ISO 13485 për prodhuesin dhe CE certifikatën për prodhuesin, ky konstatim i ekspertit nuk qëndron sepse nëse analizohen Iso dhe Ce certifikatat e prezantuara shihet qartë se këto certifikata nuk janë adekuate, pra nuk janë konform kërkesës së dosjes së tenderit. Gjithashtu ne kemi kontaktuar edhe me prodhuesin në Lidhje me certifikatat e Lartcekura, ku na është konfirmuar edhe nga ana e tij se nuk i posedojnë këto certifikata. Iso Certifikata prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk përmban Iso për plazma sterilizator, ku nëse analizohet shihet qartë tek pjesa e Certifikatës 45014 APPLICABLE TO:

Ndërsa tek pjesa CE 1282 është Certifikatë me standard dhe direktive 2014/68/ EU qe është direktive mbi produktet me presion dhe kjo Certifikatë nuk përfshin produktet medicionale dhe ne rastin tone CE 1282 është parking example. Duke u bazuar në këto dëshmi të cilat po ju a bashkëngjisim vërtetohet Se Iso Certifikata 13485 për prodhuesin dhe CE certifikata për prodhuesin nuk janë sipas kërkesës së FDT-së dhe të njoftimit për kontratë. Prandaj është për tu habitur fakti se si eksperti shqyrtues ka konstatuar se janë prezantuar certifikatat duke mos i analizuar se a janë apo jo konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe se a janë adekuate ato certifikata. Nuk pajtohemi edhe me përgjigjen në pretendimin nr. 4 të ekspertit shqyrtues, pasi që ne nuk e kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim brenda afatit ligjor. Konstatimi i ekspertit se AK-ja e ka kthyer përgjigjen në kërkesën tonë për rishqyrtim me dt. 29.10.2020, nuk qëndron, për faktin se ne me dt.02.11.2020 kemi pranuar përgjigjën në kërkesën tonë për rishqyrtim, e që i bie të jetë dita e gjashtë pas pranimit të kërkesës tonë për rishqyrtim, pra jashtë afatit ligjor për kthimin e përgjigjes në lidhje me kërkesën për rishqyrtim. Ndërsa neni 108/A paragrafi 6 i LPP- së e parasheh qartë *se* ".Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara nënparagrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre [3j ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë ",pra ne jo vetëm që nuk kemi pranuar vendim për refuzim të kërkesës për rishqyrtim brenda tri ditëve, mirëpo nuk kemi pranuar as ndonjë njoftim për zgjatjen e afatit. Andaj shihet qartë se eksperti shqyrtues nuk e ka analizuar në tërësi procesin e kthimit të përgjigjes, pasi që është bazuar vetëm në vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim ku shkruan data 29.10.2020, mirëpo ne nuk e kemi pranuar atë vendim deri me dt. 02.11.2020 siç

e cekëm më lartë. Duke u bazuar në ankesën që e kemi parashtruar, në ekspertizën e ekspertit shqyrtuese dhe në të gjitha faktet tona, kërkojmë nga paneli shqyrtues që të aprovohet ankesa jonë si e bazuar, dhe të konfirmohet papërgjegjshmëria e OE të rekomanduar për kontratë dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Me respekt,

Driton SANAJA.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 23.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "SOLUTION D" SH.P.K, se autoriteti kontraktues nuk ka lejuar qasjen në dokumentet tenderuese me arsyetimin se janë të klasifikuara si sekrete afariste në bazë të Nenit 11 të LPP-së. Operatori ekonomik ankues "SOLUTION D" SH.P.K me datën 23.10.2020 ka paraqitur kërkesën për qasje në dokumentet tenderuese të operatorëve ekonomik ofertues. Paneli Shqyrtues sqaron se në bazë të Nenit 114 të LPP paragrafit 1 pikës (ii), eksperti shqyrtues ka kontaktuar autoritetin kontraktues me datën 03.11.2020 lidhur me kërkesën për qasje në dokumentet tenderuese të paraqitur nga ana e OE ankues, ku ka kërkuar nga AK si në vijim: "Po ju shkruaj në cilësinë e ekspertit shqyrtues lidhur me procedurën e prokurimit "Furnizim me Sterilizator Plazma me Material përcjellës hargjues" me nr. të prokurimit 220-70001-0731-20-5789-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK), Spitali i Përgjithshëm në Gjilan. Në këtë procedurë siç jeni te njoftuar keni ankesë te dorëzuar ne OSHP nga ana e OE sipas ankesës nr. 871/20 te dt. 30.10.2020. Pretendimi ankimor është mos lejimi në qasjen e dokumenteve të operatorit ekonomik në bazë të LPP-së, ju lutemi na dërgoni vendimin e AK mbi pranimin e sekretit afarist të paraqitur nga ana e OE si dhe procesverbalin e qasjes. Mundësisht brenda ditës të përgjigjeni në kërkesën tone". Lidhur me këtë kërkesë, Paneli Shqyrtues sqaron se me datë 04.11.2020 eksperti ka pranuar këtë përgjigje nga ana e AK si në vijim: "I nderuar z. Bajrami ne attachment gjeni te bashkangjitur deklaratën afariste. Ndërsa lidhur me kërkesën tuaj për procesverbalin e qasjes nuk kemi bere e kemi njoftuar edhe ne email, edhe pse operatori ekonomik ka qene zyrtarisht ne zyre tona i ka shikuar te gjitha dokumentet dhe ka thënë qe te gjitha i paska, por e kam njoftuar se nuk kam te drejti ti jap sepse është nënshkruar ANEKS 3. Sa i përket te gjitha dokumentet tjera janë ne Sistem E Prokurim.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues me rastin e paraqitjes së sekretit afarist nga ana e operatorit ekonomik është dashur që të veproj konform Nenit 11 paragrafit 5 të

LPP-së dhe të trajtoj në mënyrë të duhur sekretin afarist të paraqitur nga ana e OE. AK nuk ka respektuar këtë dispozitë duke mos treguar, njoftuar se cilat dokumente pranohen si sekret afarist por që ka pranuar të gjitha si të tilla. Andaj, në këtë rast AK është dashur që në bazë të nenit 11 paragrafit 3 të shqyrtoj se kërkesat për sekret afarist, i tërë dokumentacioni a i përmbushin pikat 3.1, 3.2 dhe 3.3 të paragrafit 3 të nenit 11 të LPP. Andaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pretendimi ankimor i operatorit ekonomik është i bazuar dhe udhëzohet AK që të veproj konform Nenit 7, 10 dhe 11 lidhur me qasjen në dokumentet tenderuese.

Pretendimi ankimor se OE i rekomanduar "SOLUTION D SH.P.K" nuk ka "Vërtetim nga banka" se ka qarkullim bankar së paku tri vitet e fundit ndërsa si dëshmi është kërkuar OE duhet të dëshmoj me vërtetim nga banka komerciale që ka qarkullim 120,000.00 euro për tri vitet e fundit. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim nuk qëndron dhe është i pa bazuar pasi që OE ka prezantuar dokumentin, vërtetimin bankar nga banka PCB me qarkullim konform kërkesës se dosjes se tenderit. Andaj, ky pretendim është i pa bazuar.

Pretendimi ankimor se operatori ekonomik i rekomanduar "SOLUTION D SH.P.K", nuk ka dokumentet sipas dosjes se tenderit te kërkuara tek kapaciteti teknik dhe profesional neni 91.&9.2 i dosjes se tenderit. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim është i pa bazuar pasi që operatori ekonomik i rekomanduar ka dorëzuar: 1.)Listën e kontratave te realizuara për tri vitet e fundit (operatori ekonomik ka prezantuar listën e kontratave dhe referencat) 2.)Autorizim nga prodhuesi për shitje dhe servisim *(BIOBASE BIODUSTRY (SHANDONG) CO.LTD* te datës 13.10.2020 3.) Certifikata ISO 13485 për prodhuesin dhe CE Certifikata për prodhuesin (Certifikata ISO 13485:2016 ME NR. 45014; CE Certifikatën nga prodhuesi me nr. BKSD-20101302; CE 1282 ECM PED – D1 2018-DD33)
4).Lista e pjesëve rezervë *(* nga prodhuesi me gjithsejtë 12 artikuj e cila përmban edhe vulën e prodhuesit). 5).Katalogu i nënvizuar *(*operatori ekonomik ka katalogun e nënvizuar nga prodhuesi BIOBASE). 6).Licenca nga AKPPM (operatori ekonomik ka prezantuar Licencën).
Kurse Certifikata ISO 9001 me anë te sqarimeve te publikuara ne e-prokurim nga ana e AK me datën 09.10.2020 është larguar si kërkesë andaj edhe ky pretendim ankimor është pa bazuar.

Pretendimi ankimor se AK nuk është përgjigjur ndaj kërkesës për rishqyrtim te parashtruar nga ana e operatorit ekonomik "SOLUTION D SH.P.K'', ky pretendim nuk qëndron pasi që OE me datën 27.10.2020 ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim pranë AK, kurse AK me datë 29.10.2020 ka kthyer përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim e cila është brenda afateve te përcaktuara me LPP, Nenin 108/A paragrafin 6. Andaj, pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues gjatë procedurës së këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka pasur parasysh nenin 7, 10 dhe 11 të LPP-së dhe me këtë rast ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që të ti merr parasysh sqarimet e dhëna në këtë vendim dhe të bëjë ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së, si the të respektoj nenin 7, 10 dhe 11 gjatë procedurës së rivlerësimit dhe pas saj.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesues i Panelit Shqyrtues

Goran MILENKOVIĆ

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "Spitali i Përgjithshëm në Gjilan";

1x1 OE "Solution D"SH.P.K,-Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.